



**Studio Ligjore LEAL**

**Adresa: Prrenjas-Pogradec,  
nr.870/2, ZK 3203, Prrenjas**

**Tel: +355 68 20 67 756**

---

## **AKT-THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA**

### **Studio LEAL**

Personi që firmos më poshtë:

**LEONARD KARAJ**, i datëlindjes 11/02/1977, i identifikuar me anë të Kartës së Identitetit me nr.H70211081B, banues në Tiranë, Shqipëri ka hartuar si më poshtë “Aktin e Themelimit” të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk), të cilën ka vendosur ta quaj: “**Studio LEAL**”

### **VEPRIMTARIA**

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare” ortakët e lartpërmendur, në bazë të vendimit të drejtuesit të datës 17/01/2023, vendosi krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Studio LEAL” për të ushtruar aktivitetin privat me objekt si më poshtë:

*Mbrojtje ligjore dhe përfaqësim i posaçëm dhe i përgjithshëm përpara të gjitha shkallëve të procesit gjyqësor. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore në fushën e legjislacionit civil, penal (gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor), administrativ, të punës, doganor, bankar dhe atij fiskal. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si shoqëri apo në bashkëpunim me studio ligjore apo avokatë. Konsulencë juridike në lidhje me formën ligjore të lindjes, ndryshimit, shuarjes së marrëdhënieve juridike të detyrimit apo atyre kontraktorë. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore për persona fizikë apo juridikë, shqiptarë apo të huaj (klient) në çështjet civile, penale dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike. Përpilim, hartim, rishikim, kontrollim të dokumentacionit të nevojshëm dhe/ose depozitim në institucionet përkatëse dhe/ose ndjekje të procedurave ligjore, sipas çështjes konkrete të klientit (kërkesëpadi apo akte të tjera juridike, prokura për përfaqësim të subjekteve të interesuara, dokumente për regjistrim të shoqërive tregtare, dokumente të shoqërive tregtare të regjistruar si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj, për ndryshimet e administratorëve, të ortakëve, ndryshimin e kapitalit, transferimin e kuotave, ndryshim statuti etj., kërkesa apo ankesa drejtuar institucioneve përkatëse, akte që i nënshtrohen veprimeve noteriale). Përpilim kontratash të të gjitha llojeve, përfshirë këtu edhe kontratat aksesore si mjete të sigurimit për përmbushjen e detyrimeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose sinon të sjellë pasoja juridike. Përgatitje të kërkesave drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave Ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon*

*Shqipëria. Hartim të testamenteve në bazë të formave të njohura nga legjislacioni civil shqiptar. Konsulencë juridike për çështjet e trashëgimisë ligjore dhe testamentare, përfaqësim në gjykatë për çeljen e trashëgimisë ligjore, kundërshtim të testamentit etj. Ndjekje të procedurave për ekzekutimin e titujve ekzekutiv në Zyrat e Përmbarimit, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit. Veprime të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj. Aplikime të të gjitha lojeve (sipas kërkesave të klientit), pranë institucioneve shtetërore ose të tjera (kadastër, ministri, AZHBR, etj) për projekte të ndryshme. Plane biznesi dhe konsulencë për hartim dokumentacioni dhe aplikime. Aplikime dhe përgatitje dokumentacioni për çdo tenderim (online dhe fizikisht).*

## **KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) lekë të reja. I gjithë kapitali zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, z.Leonard Karaj.

## **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

## **SELIA**

Selia do të jetë sipas adresës: **Rruga nacionale Prrenjas-Pogradec (kompleksi BOTANIKA), Nr.pasurie 870/1, Kati 2, Zona Kadastrale 3203, Prrenjas.**

## **FINANCA**

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31/12/2023. Vitet e tjera financiare fillojnë më 1 janar dhe përfundojnë më 31 dhjetor.

## **ADMINISTRATORI**

Administratori i shoqërisë do të jetë: z.Leonard Karaj, i datëlindjes 11/02/1977, i identifikuar me anë të Kartës së Identitetit me nr.H70211081B, banues në Tiranë, Shqipëri. Ai do të bëjë përfaqësimin ndaj të tretëve.

## **DISPOZITË**

Ky Akt–themelimi është hartuar më 15/01/2023 në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore. I përfaqësuar në bazë të vendimit datë 15/01/2023

**Ortaku i Vetëm i shoqërisë  
“Studio LEAL” shpk  
Leonard KARAJ**